

VENDIM
Nr. 141, datë 6.6.2022

**MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “TREN SUN SYSTEM” SHPK,
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2000 kW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe neneve 13 dhe 14, pika 2, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s”, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 866/2 prot., datë 2.6.2022, “Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë ‘Tren Sun System’ sh.p.k., për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2000 kW”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 80, datë 14.4.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Tren Sun System” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE me shkresën nr. 70/9 prot., datë 20.4.2022, bëri njoftimin në media për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve dhe objeksioneve (datë 29.4.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Po ashtu, me shkresën nr. 448/1 prot., datë 21.4.2022, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës, si dhe me kërkesën për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe lejet nga institucionet respektive.

- Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim – neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”, “g”.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, gjerat “a”, “d”.

- Dokumentacioni teknik për HEC-in – neni 9, pikat 4.4.2, 4.4.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.4.4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”.

- Leje nga institucione të tjera – neni 9, pika 4.4.5, germa “b”.

Dokumentacioni i konstatuar në mungesë është:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).

Shoqëria nuk ka depozituar vërtetimet e gjykatës dhe Prokurorisë së Qarkut Korçë për administratorin dhe shoqërinë, duke qenë se ka seli vetëm në këtë qark.

- germa “f” (Marrëveshje Koncensionale apo çdo formë tjetër e marrëveshjes në rastet e aplikueshme të lidhur me institucionet përgjegjëse të ngarkuara me ligj, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës, si dhe ndryshim të këtyre akteve.)

Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE dokumentacionin përkatës (marrëveshje/kontratë me MIE-n), në vijim të miratimit të MIE-s nr. 1013/4 prot., datë 11.3.2022. Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3:

- germa “b” (bilanci financiar i tre viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit).

Shoqëria nuk ka depozituar pasqyrat financiare të vitit 2021.

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimi dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.).

Dokumenti i depozituar nga shoqëria në kuadër të shprehjes së interesit, nga banka gati përpara një viti, nuk është përcjellë në kuptim të rregullores me datë të rifreskuar dhe nuk është bërë me dije nëse është nënshkruar me bankën kontratë për të siguruar 80 % të investimit dhe as se si do të mbulojë 20% të vlerës së investimit.

Dokumentacioni tekniko-ekonomik. Neni 9, pika 4.1.4

Shoqëria nuk ka depozituar të dhënat për centralin prodhues dhe emrin e centralit (pasi në formular rezulton se është plotësuar ky seksion duke vendosur vetëm emrin e shoqërisë). Gjithashtu, duhet të bëhet saktësim edhe në lidhje me numrin e njërive gjeneruese dhe kapacitetit të secilës pasi nga të dhënat që ka përcjellë rezulton se 15 njësi x 175 kW është e barabartë me 2625 kW, çka kalon edhe kapacitetin prej 2000 kW, për të cilin kërkohet licencimi.

- Shoqëria nuk ka bërë me dije në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit apo fazën në të cilën ndodhen.

- Mungon përcaktimi i qartë i viteve brenda të cilëve do të ndërtohet projekti, në kuptim të zbatimit të grafikut të punimeve (pasi ky i fundit parashikon ndërtimin brenda një periudhe 24 mujore, por pa përcaktuar vitet konkrete). Duke qenë se në aplikimin e shoqërisë “Tren Sun System” sh.p.k. mungon një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit, si dhe nisur nga fakti që kjo shoqëri, nuk ka përcjellë asnjë shkresë për plotësim dokumentacioni apo kërkesë për shtyrje të kësaj procedure, vlerësohet të refuzohet kërkesa e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “Tren Sun System” sh.p.k., për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2000 kW.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti